

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm, në trupin gjykues të përbërë nga Gjyqtari Ahmet Idrizaj - Kryetar i trupit gjykues dhe gjyqtarëve porotë Fahredin Meqa dhe Ismet Këndusi – anëtar të trupit gjykues, në çështjen juridiko-civile të propozueses K. Sch. nga Gj. të cilën e përfaqëson i autorizuari P. K, avokat në Gjakovë dhe të propozuesit L. Sch. , nga fshati M., Komuna e Gj., me bazë juridike: zgjidhje e martesës, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor jopublik, të mbajtur me datë 19.11.2018, në prezencën e të autorizuarit të propozueses dhe të propozesit, mori këtë:

A K T G J Y K I M

ZGJIDHET martesë e lidhur në mes të propozuesve K. Sch. nga Gj. dhe L. Sch., nga fshati M., Komuna e Gj., e lidhur në Zyrën e Gjendjes Civile në fshatin C., Komuna e Gj., me datë 04.10.2016, nën nr. rendor 40, me nr. të referencës 2/..., në kuptim të nenit 68 pika 1, të Ligjit për Familjen i Kosovës.

Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit me datë 08.03.2018, në këtë gjykatë kanë parashtruar propozim të përbashkët për zgjidhjen e martesës me marrëveshje duke theksuar se në fillim raportet në mes të bashkëshortëve-propozuesve, kanë qenë të mira, mirëpo me kalimin e kohës, për shkak të mentalitetit dhe për shkak të largësisë së tyre, raportet janë ç'rregulluar në atë masë, sa që kanë marrë karakter të përhershëm, ashtu që nuk ka mundësi që raportet në mes të palëve të rivendosen sëriish. Më tej kanë theksuar se me datë 25.12.2016, ka ardhur deri te shpëputja faktike e bashkësisë martesore ashtu që nga kjo kohë e tutje, palët në procedurë jetojnë ndaras dhe atë propozuesja jeton në Gj. ndërsa propozuesi jeton në K.

I autorizuari i propozueses dhe propozuesi në fjalën e tyre përfundimtare deklaruan se : në rastin konkret i propozuan gjykatës që të zgjidhet me marrëveshje martesë e lidhur në mes të palëve në procedurë. Ndaj aktgjykimit miratues në rastin konkret hoqën dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës.

Nuk i kërkuan shpenzimet procedurale.

Gjykata pas vlerësimit të fakteve relevante në këtë çështje dhe zbatimit të provave si dhe rezultatit të rrethanave jokontestuese në mes të palëve dhe në pajtim me nenin 8 të LPK-së, vërtetojë se propozimi i propozuesve është i themeltë dhe si e tillë u miratua.

Nga provat e zbatuara është argumentuar gjendja faktike si në vijim :

Nga palët ndërgjyëse rezultojë si jokontestuese rrethana se çifti bashkëshortor që nga data 25.12.2016, e tutje e kanë shpëputur bashkësinë faktike martesore dhe jetojnë ndaras dhe atë propozuesja jeton në Gj. ndërsa propozuesi jeton në K.

Nga Certifikatë martesë me nr. rendor ... me nr. të referencës 2/... e lëshuar në Zyrën e Gjendjes Civile në Gj. me datë 04.10.2018, rezulton se këtu propozuesit kanë lidhur martesë me datë 04.10.2016 në Ofiqarinë e Zyrës së Gjendjes Civile në fshatin C., Komuna e Gj.

Kjo gjykatë, konsideron se në rastin konkret, janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me nenin 68 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Familje të Kosovës (Ligji nr.34/32 i dt. 20 janar 2006), meqë martesë e lidhur në mes të palëve në procedurë, e ka humbur qëllimin dhe efektin e vet për të cilin është lidhë. Palët në procedurë jetojnë veçmas që data 25.12.2016, nuk kanë pasur dhe as që presin fëmijë të përbashkët në mes veti dhe për këtë arsye dhe nga këto fakte rezulton se propozimi i tyre është i themeltë dhe si i tillë u miratua.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u muar sipas nenit 450 të LPK-së, dhe deklarimit të palëve në procedurë.

Nga të lartë cituarat u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË.
C.nr.646/2018 datë 19.11.2018

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES
GJYQTARI,
Ahmet Idrizaj

UDHËZIM JURIDIK; Ky aktgjykim është i formës së prerë prej ditës së sodit, pasi që palët në procedurë hoqën dorë nga drejta e ushtrimit të ankesës.